

VENDIM
Nr. 894, datë 21.12.2016

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË INSPEKTORIT ERVIN ROBERT
HAXHIU, ISH-PUNONJËS POLICIE, I CILI KA HUMBUR JETËN
NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, familjes së Inspektor Ervin Robert Haxhiu, ish-punonjës policie në Komisaratin e Policisë nr. 5, Kamzë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, i cili ka humbur jetën në krye të detyrës.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Mistrria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi